

VENDIM
Nr.533, datë 22.11.1999

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.209, DATË
28.4.1999 “PËR CAKTIMIN E ADMINISTRATORËVE TË PAVARUR NË SHOQËRITË
HUAMARRËSE, SUBJEKTE TË KONTROLLIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 9, të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997, “Për disa ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të nenit 5, të ligjit nr.8471, datë 8.4.1999, “Për nxjerrjen e detyrimeve debitore dhe rikthimin e vlerave pasurore në llogaritë e personave juridikë, jobankare, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë” dhe të nenit 5, të ligjit nr.8472, datë 8.4.1999, “Për rikthimin në shoqëritë huamarrëse të vlerave financiare të përfituara nga ana e personave fizikë e juridike, nga shitja e pasuritë apo transaksioneve të pronësisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave nga shitja e pasurisë apo transaksioneve të pronësisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Në vendimin e Këshillit të Ministrave br.209, datë 28.4.1999, pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“Për arktëtimin e detyrimeve debitore dhe të vlerave financiare, të përfituara prej personave që kanë kryer shitje të pasurisë apo të transaksioneve të pronësisë, në përbërjen e administratorëve të përbashkët të shoqërive huamarrëse në administrim, të jetë jurist për të bashkërenduar veprimet me zyrat e përparimit gjyqësor.

Grupi i Mbikëqyrjes, në varësi të vëllimit të pinës që ka secila shoqëri huamarrëse, realizon zëvendësimin e njerit prej administratorëve të përbashkët me atë të specialistit jurist.

Paga mesatare mujore e juristëve të jetë e njëjtë me ato të administratorëve të përbashkët. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i miratuar për Grupin Mbikëqyrës.

2.Ngarkohet Grupi Mbikëqyrjes për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta